



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E TE ARDHURAVE DHE LICENSIMIT

PAKETA FISKALE
2024

Dhjetor , 2023

Bazuar ne Ligjin nr.9632 date 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore “ i ndryshuar, ligji nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”, ligji nr.9723 datë 03.05.2007 “Per regjistrimin e biznesit ”, I ndryshuar, ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, V.K.M nr.132 datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme ndërtesa, bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit të të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës , si dhe kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës” I ndryshuar. Ligji nr.8438 datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të ardhurat “i ndryshuar, ligji nr.10081 datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”. Ligji nr.9975 datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” i ndryshuar. Ligji nr.9482 datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” I ndryshuar, ligji nr.107/2014 date 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”. Ligji nr.10465 datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligji nr.10279 datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative” ligji nr.10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve “ i ndryshuar. V.K.M. nr.179 datë 09.03.2016 “Për miratimin e statutit të Qëndres kombëtare të Regjistrimit”, V.K.M Nr.783 datë 10.11.2011 “Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njesitë e qeverisjes vendore” I ndryshuar, V.K.M Nr.54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar. V.K.M Nr.391 datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e Pyjeve dhe Kullotave” I ndryshuar me V.K.M Nr 1064 date 22.12.2010 (Per disa ndryshime ne vendimin Nr 391 date 21.06.2006 te Kishillit te Ministrave). V.K.M nr.285 datë 27.06.2002 “Për tarifatat e shërbimeve që kryen Policia e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit ndaj shtetasve dhe personave, juridike, fizike, vendas dhe të huaj” Ligjit nr.68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore”, Ligjin nr.152/2015 date 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”, Ligji nr.24/2017 “ Për administrimin e Ujitjes dhe Kullimit” , Ligji nr.10465 datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë” I ndryshuar, VKM nr.319 date 31.05.2018 (Per miratimin e masave per kostot e menaxhimit te integruar te mbetjeve).

Përmbajtja

Taksat vendore

1. TATIM I THJESHTUAR MBI FITIMIN PER BIZNESIN E VOGEL

1.1 TATIMI MBI TE ARDHURAT PERSONALE

2. TAKSA MBI PASURINE E PALUAJTSHME

- Takse mbi Ndertesat
- Takse mbi Token Bujqesore
- Taksa mbi Truallin

3. TAKSA E FJETJES NE HOTEL

4. TAKSA MBI KALIMIN E TE DREJTES SE PRONESISE MBI PASURITE E PALUAJTSHME

5. TAKSA E NDIKIMIT NE INFRASTRUKTURE NGA NDERTIMET E REJA

6. TAKSA E REGJISTRIMIT TE PERVITSHEM TE MJETEVE

7. TAKSA E TABELES DHE REKLAMES

8. TAKSA PER DHENIEN E LICENSAVE PER TREGETIMIN ME PAKICE TE KARBURANT

9. TE ARDHURA NGA TE TRETE.

Tarifat vendore

1. TARIFA E PASTRIMIT

2. TARIFE NDRICIMI

3. TARIFE GJELBERIMI

4. TARIFA E ZENIES SE HAPESIRES PUBLIKE

5. TARIFE PER CERTIFIKATAT DHE LEJAT E TRANSPORTIT

6. TARIFE LEJE (NON STOP)

7. **TARIFE PARKIMI**
8. **TARIFE PER SHERBIM VARIMI**
9. **TARIFA TE NDRYSHME BASHKIE**
10. **TARIFE PER QERA TRUALLI**
11. **TARIFE CERDHE**
12. **LLOJET DHE NIVELET E GJOBAVE TE BASHKISE DEVOLL**
13. **TARIFAT PER SHITJE TE PRODUKTEVE BUQESORE DHE TARIFA PER SHERBIMIN E UJITJES**
14. **MASA E DEBISE NGA TAKSAT DHE TARIFAT FAMILJARE DHE ATO TE BIZNESIT**

Taksat vendore

1. Taksa e Tatimit te Thjeshtuar mbi Fitimin per Biznesin

Cdo subjekt,i cili kryen nje biznes,me ane te te cilit realizohet gjate vitit fiskal qarkullim me i vogel ose i barabarte me 8.000.000 (*tete milion*) leke i nenshtrohet detyrimit te pageses se tatimit te thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel, por per vitin 2023 me vendim Qeverie me akt normative Nr 19 date 23.04.2020 u perjashtuan te gjitha bizneset e vogla me xhiro vjetore deri ne 14.000.000 (*katermbedhjete million*) leke ne lidhje me tatim fitimin .

Baza e takses/tatimit;Kestet e parapagimit te tatimit te thjeshtuar mbi fitimin,per vitin vijues,per tatim paguesit me qarkullim vjetor mbi 14 milion leke llogariten ne baze te te dhenave te deklarates tatimore te nje viti me pare.

Niveli i tatimit:Nivelet e tatimit te thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel paraqiten si ne tabelen e meposhtme;

Taksa e Tatimit te Thjeshtuar mbi Fitimin per Biznesin leke/vit

Nr	Qarkullimi vjetor i biznesit	Niveli i Takses		E Ardhura e Parashikuar (lek)	
		Nj.Bilisht	Nj.e Tjera	Nj.Bilisht	Nj.e Tjera
1.	Me qarkullimvjetor nga 0 – 2.000.000lekë	0	0	0	0

2.	Me qarkullim vjetor nga 2.000.001 – 10.000.000 lekë	0	0	0	0
3.	Me qarkullim vjetor 10,000,000- 14.000.000 leke	15% e fitimit	15% e fitimit		
	TOTALI				90,000

Tabela.1

Menyra e pageses: Tatim paguesi parapaguan ne llogarine e organeve tatimore kestet tremujore te tatimit te thjeshtuar mbi fitimin te biznesit te vogel Brenda dates 20 Prill per tremujorin e pare, brenda dates 20 Korrik per tremujorin e dyte, brenda dates 20 tetor per tremujorin e trete dhe brenda dates 20 Dhjetor per tremujorin e kater.

Struktura pergjegjese per vjeljen e takses/tatimit: Drejtoria Rajonale Tatimore ne rolin e agjentit tatimor eshte e ngarkuar per mbledhjen e kesaj takse dhe kalimin e saj per llogari te buxhetit te qeverisjes vendore te te ardhurave nga tatimi I thjeshtuar mbi fitimin e biznesit te vogel.Per kete sherbim D.R.T Korce perfiton 1 % te te ardhurave nga ky ze.

Te ardhurat e parashikuara nga kjo takse: Per vitin 2024 nga rakordimet e nxjera midis Drejtorise Rajonale Tatimore Korce dhe Bashkise Devoll me shkrese Nr8811/1Prot date 06/11/2023 parashikimi i kesaj Takse per arketim per vitin 2024 do te jete ne nivelin prej 90.000 Lek .

TATIMI MBI TE ARDHURAT PERSONALE

Ne zbatim te germes ç, pika 2 e nenit 25 te ligjit nr 68, date 27.04.2017 “Per financat e veteqeverisjes Vendore” njesite e veteqeverisjes vendore jane perfituese te 2% nga Tatimi mbi te Ardhurat Personale (TAP) qe realizohen ne juridiksjonin e tyre. Per vitin 2023 Tatimi mbi te Ardhurat Personale u shpernda ne baze te numrit te popullsise se Bashkive per arsye se nuk eshte gjetur akoma mekanizimi i duhur teknik sipas juridiksjonit te punonjesve ku mblidhet tatimi. Per efekte te perlllogaritjes se tatimit mbi te ardhurat personale do te merren si te ardhura te tatueshme, te ardhurat e percaktuara ne nenin 8 te ligjit nr 8438 date 28.12.1998

“Per Tatimin mbi te ardhurat” i ndryshuar.

Tatimi mbi te Ardhurat Personale (TAP)

Nr.	Emertimi i Takses	Niveli i Takses		E Ardhura e Parashikuar (lek)	
		Nj.Bilisht	Nj.e Tjera		
1.	Tatimi mbi te Ardhurat Personale			9,000,000 lek	
	TOTALI	9,000,000 lek			

Tabela.2

2.TAKSA MBI PASURINE E PALUAJTSHME

Taksat mbi pasurine e paluajtshme i nenshtrohen te gjithe personat fizike ose juridike, vendas ose te huaj, pronare apo perdorues te pasurive te paluajtshme ne territorin e Republikes se Shqiperise, pavaresish nga niveli i shfrytzezimit te ketyre pasurive. Bejne perjashtim rastet kur ne ligj parashikohet ndryshe. Detyrimi per taksen mbi pasurine e paluajtshme e ka sipas rastit pronari ose bashkepunatori sipas pjeses qe zoteron apo perdoruesi i pasurise se paluajtshme per pasurite qe nuk jane te pajisura me dokumente pronesis. Ne taksat mbi pasurine e paluajtshme perfshihen:

- 1. Taksa mbi ndertesën**
- 2. Taksa mbi token bujqesore**
- 3. Taksa mbi truallin**

Ne rast te mungeses se dokumentacionit te pronesis (ndertesë, toke bujqesore, truall) perdoruesi i pasurise ben nje vetedeklarim te siperfaqes prane bashkise. Bashkia nepermjet komisionit te ngritur mund te vleresoje siperfaqen e taksueshme.

➤ **Takse mbi ndertesat**

Përkufizime:

"Çmim vlerësues", njësi matëse e vlerës për metër katror të sipërfaqes së ndërtimit të pasurisë së paluajtshme. Ky çmim mund të jetë çmimi i tregut ose çmimi i vlerësuar.

"Ndërtesë", objekti/objektet e ndërtuara mbi/nën sipërfaqen e tokës ose të lidhura me tokën dhe që përfaqëson një strukturë ndërtimore me një ose më shumë njësi pronësore, e cila është objekt i taksës mbi ndërtesën sipas përcaktimit të dhënë në ligj.

"Ndërtesë e papërfunduar", objekti ndërtimor në tërësi ose/edhe ajo pjesë e ndërtesës ekzistuese, për të cilin zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi, por që nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

"Njësi pronësore", ndërtesa ose pjesë e saj, e cila është në pronësi/përdorim të individit, të një personi fizik apo të një personi juridik, dhe që është e ndarë ligjërisht nga pronat e tjera të pasurisë së paluajtshme "ndërtesë". Njësi pronësore mund të përdoret për qëllim banimi ose/edhe për qëllim veprimtarie ekonomike etj.

"Ndarje e njësisë pronësore për banim", pjesa e njësisë pronësore që përdoret për qëllim banimi.

"Ndarje e njësisë pronësore për veprimtari ekonomike", pjesa e njësisë pronësore që përdoret për qëllim veprimtarie ekonomike.

"Përdorues", individi, personi fizik ose personi juridik, që ka në përdorim ndërtesën/njësine pronësore për qëllime banimi, veprimtari ekonomike apo për veprimtari joekonomike, pavarësisht nga fakti nëse kjo ndërtesë/njësi pronësore ka titull pronësie ose jo.

"Taksapagues", çdo individ, person fizik ose juridik, vendës ose i huaj, pronar apo përdorues i pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave. Detyrimin për pagimin e taksës mbi pasurinë e paluajtshme "ndërtesë" e kanë, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente të pronësisë, personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse të lëshuar nga njësi e vetëqeverisjes vendore.

"Vlerë e pasurisë", Vlera e pasurisë është baza e taksueshme mbi të cilën aplikohet shkalla e taksës së pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore. Vlera e pasurisë llogaritet si shumëzim i çmimit për metër katror me sipërfaqen e ndërtesës/njesisë pronësore.

"Veprimtari ekonomike", çdo veprimtari e kryer nga prodhuesit, tregtarët, personat që furnizojnë mallra dhe shërbime, përfshirë veprimtaritë nxjerrëse, industriale, tregtare, të shërbimit, bujqësore dhe veprimtaritë profesionale. Veprimtari ekonomike konsiderohet, gjithashtu, shfrytëzimi i pasurisë së trupëzuar ose të patrupëzuar, me qëllim realizimin e të ardhurave me karakter të vazhdueshëm.

- Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në ligj përcaktohen ndryshe.
- Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje".
- Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përlllogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.
- Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.
- Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Pagesa e taksës bëhet çdo muaj apo për periudha më të gjata, në varësi të kategorisë së taksapaguesit.

- Çmimi mesatar referues i shitblerjes së ndërtesave që përdoren për qëllim banimi për Bashkinë Devoll është **35 000 lekë/m²**.
 - Çmimet mesatare për metër katror sipërfaqe ndërtimi për ndërtesat që nuk shërbejnë për banim janë si më poshtë vijon:
1. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari tregtimi dhe shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve. Në këtë kategori do të përfshihen edhe ndërtesa tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhim, tregtim ose/edhe shërbime me pakicë.
 2. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.
 3. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të hapur është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit në qytet.
 4. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale, si: prodhim, përpunim ose magazinim të mallrave industriale, duke përfshirë fabrikat, depot, magazinat dhe objektet e tjera të ngjashme, është 50 (pesëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse.
 5. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi që përdoren për bujqësi dhe blegtori apo veprimtari mbështetëse, si grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, me përjashtim të përpunimit ushqimor.
 6. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për banim në njësitë administrative jashtë qytetit, të cilat iu bashkuan njësisve të vetëqeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 115/2014, reduktohet deri në 35 (tridhjetë e pesë) për qind, krahasuar me çmimin e zonës më të afërt, përjashtuar zonat rezidenciale.
 7. Për ndërtesat e privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", të ndryshuar, çmimi për metër katror është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit, vetëm në rastin e shitjes së pare.

Shkalla e taksës mbi ndërtesat:

Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si më poshtë:

- a) 0,05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;
- b) 0,2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
- c) 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Për ndërtesat në pronësi të shoqërive të ndërtimit, të destinuara për shitje, por që janë ende të pa shitura, taksa do të vendoset sipas destinacionit të përdorimit të ambientit të ndërtesës. Ambiente të hipotekuara si:

- Apartamente banimi do ti nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë “*ndërtesa që përdoret, shfrytëzohet për banim*”.
- Njësi biznesi do ti nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë “*ndërtesa që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike*”.
- Bodrum/parking i mbuluar do ti nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë “*ndërtesa që përdoret për parkim të mbuluar dhe bodrume*”.

Për sa i përket kategorisë ndërtesa që përdoret, shfrytëzohet për banim nëse identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja e ndërtesës/njesisë pronësore, përdoren vlerat referuese për sipërfaqe, si më poshtë vijojnë:

a) 100 (njëqind) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim;

b) 70 (shtatëdhjetë) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim, të privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, “*Për privatizimin e banesave shtetërore*”, të ndryshuar.

Për sa i përket kategorisë ndërtesa që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike nëse identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja e ndërtesës/njesisë pronësore, njësitë e vetëqeverisjes vendore bëjnë verifikimin në terren, për të përcaktuar sipërfaqen dhe për të llogaritur bazën e taksës. Llogaritja e taksës së ndërtesës është bërë në mbështetje të V.K.M nr

132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, baza e taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës” nenit 2 pika 3 ku thuhet:

Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të miratojnë nënndarje zonale/nënzonale të territorit, brenda juridiksionit të tyre, për zbatimin e niveleve të shkallës së taksës brenda kufijve plus 30 (tridhjetë) për qind ose minus 30 (tridhjetë) për qind. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, jo më shpesh se një herë në vit, për banesat në njësitë administrative jashtë qytetit përkatës, të cilat iu bashkuan njësive të qeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 115/2014, mund të reduktojë çmimin mesatar referues të përcaktuar në aneksin 1, deri në

masën minus 35 (tridhjetë e pesë) për qind, krahasuar me çmimin e zonës më të afërt, përjashtuar zonat rezidenciale. **Kjo taksë miratohet pa ndryshim si në vitin 2023.**

1. Taksa mbi ndërtesa për qëllime banimi.

Emërtimi	Vlera në lekë/m sipas Ligjit 106/2017	0% mbi shkallën e taksës
Banesa Bilisht	<u>17.5 lek</u> (35000 * 0.05%)	17.5 lek/m ²
Banesa Njësi Admin.	12.25 lek (35000*0.035%)	12.25 lek /m ²

2. Njësi tregëtimi dhe shërbimi.

Emërtimi	Vlera në lekë/m ² sipas Ligjit 9632 (taksa ka qënë)	Vlera në lekë/m ² sipas Ligjit 106/2017 (taksa bëhet)	0% mbi shkallën e taksës
Njësi tregëtimi dhe shërbimi	200	105 (52,500*0.2%)	105 lekë/m ²

3. Veprimtari bujqësore dhe blegtorale.

Emërtimi	Vlera në lekë/m ² sipas Ligjit 9632 (taksa ka qënë)	Vlera në lekë/m ² sipas Ligjit 106/2017 (taksa bëhet)	0% mbi shkallën e taksës
Veprimtari bujqësore dhe blegtorale	40 lekë	21 lekë (10500*0.2%)	21 lekë/m ²

4. Parkime të mbyllura dhe bodrume gjithashtu dhe te hapura .

Emërtimi	Vlera në lekë/m ² sipas Ligjit 9632 (taksa ka qënë)	Vlera në lekë/m ² sipas Ligjit 106/2017 (taksa bëhet)	0% mbi shkallën e taksës
Parkime të mbyllura dhe bodrume	40 lekë	49 lekë (24500*0.2%)	49 lekë/m ²

Emërtimi	Vlera në lekë/m ² sipas Ligjit 9632 (taksa ka qënë)	Vlera në lekë/m ² sipas Ligjit 106/2017 (taksa bëhet)	0% mbi shkallën e taksës
Parkime të hapura në Bashki	40 lekë	21 lekë (10500*0.2%)	21lekë/m ²

5. Veprimtari industriale në Bashki.

Emërtimi	Vlera në lekë/m ² sipas Ligjit 9632 (taksa ka qënë)	Vlera në lekë/m ² sipas Ligjit 106/2017 (taksa bëhet)	0% mbi shkallën e taksës
Veprimtari Industriale	100 lekë	35 lekë (17500*0.2%)	35 lekë/m ²

Veprimtari Industriale	100 lekë	35 lekë (17500*0.2%)	35 lekë/m ²
------------------------	----------	-------------------------	------------------------

Taksa mbi Ndertesat

Nr.	Kategorite e Ndertesave	Niveli i Takses		leke/m2/vit	
				Ardhura e Parashikuar (leke)	
	FAMILJET	<i>Nj.Bilisht</i>	<i>Nj.e Tjera</i>	<i>Nj.Bilisht</i>	<i>Nj.e Tjera</i>
1.	Ndertesa para vitit 1993	17.5 lek/m2	12.25 lek/m2	2,865,000	2,980,000
2.	Ndertesa gjate dhe pas vitit 1993	17.5 lek/m2	12.25 lek/m2	4,850,000	3,950,000
A	TOTALI			14,645,000	
	NDERTESA PER BIZNESE	<i>Nj.Bilisht</i>	<i>Nj.e Tjera</i>	<i>Nj.Bilisht</i>	<i>Nj.e Tjera</i>
1.	Ndertesa per Tregeti dhe Sherbime	105 lek/m2	105 lek/m2	1,120,000	1, 551,250
2.	Ndertesa per veprimtari industriale	35 lek/m2	35 lek/m2	336,400	552,248
3.	Ndertesa per veprimtari dhe bujqesi blegtori,magazine (Frigorifere) .	21 lek/m2	21 lek/m2	332,655	582,447
B	TOTALI			4,475,000	
	PARKIM	<i>Nj.Bilisht</i>	<i>Nj.e Tjera</i>	<i>Nj.Bilisht</i>	<i>Nj.e Tjera</i>
1.	I hapur	21 lek/m2	0	30,000	0
2.	I mbyllur dhe bodrume	49 lek/m2	0	0	0
C	TOTALI			30,000	
	TOTALI (A+B+C)	19,150,000			

Tabela.3

Detyrimi per pagese i takses mbi ndertesat eshte vjetor. Drejtoria e te ardhurave kryen llogaritjen ne baze te siperfaqes dhe vleres se takses sipas tabelës me siper.

1. **Struktura pergjegjese per vjeljen e takses:** Detyrimi per familjaret e Njesise Administrative Bilisht si dhe per fshatrat e cdo Njesie Administrative te cilat furnizohen me uje te pijshme nga Ujesjelles SH.A ,shlyhet ne baze mujore si pjese perberese e fatures se sherbimit te furnizimit me uje nga Ujesjellesi Korce ne cilesine e agentit tatimor. Per sherbimin agjenti perfiton 2 % te shumes se arketuar. Ndersa tek fshatrat e

Njesive Administrative te cilat nuk jane te mbuluar nga furnizimi me uje te pijshem nga Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Korce Sha,taksat familjare do te mblidhen nga punonjesi e taksave ne njesine perkatese duke shkuar ne cdo familje. Deri ne perfundimin e hedhjes te te dhenave per sipërfaqet e banimit ne sistemin e ngritur nga kadastra fiskale detyrimi vjetor i takses se ndertesave per nje pjese te vogel te familjeve te cilat nuk jane evidentuar sipërfaqet e ndertesave , llogaritet per nje sipërfaqe mesatare prej 100 m² per ndertesat e ndertuara pergjate dhe pas vitit 93 si dhe me nje sipërfaqe prej 70 m² per ndertesat e ndertuara para vitit 93.Nga e ardhura faktike e rakorduar nga dega e thesarit per periudhen Janar –Nentor dhe duke llogaritur periudhen e mbetur gjithashtu duke mare parasysh edhe rreth 20% e ardhur e munguar per vitin 2023 konkludojme qe e ardhura e pritshme per kete ze per takse ndertesave per familje te jete ne shumen e percaktuar ne tebele.

Detyrimi per taksen e ndertesave per kategorite Biznese duhet te paguhet brenda dates 30.06.2024. Theksojme se per shumicen dermuese te subjekteve sipërfaqja eshte llogaritur ne baze te dokumentacionit dhe per nje numer te kufizuar eshte mare ne konsiderate vetedeklarimi.

Përjashtime: Përjashtohen nga pagesa e taksës së ndërtesës:

- a) Pronat e shtetit dhe të njesive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- b) Pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- c) Ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- ç) Banesat sociale në pronësi të bashkive;
- d) Pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale; dh) Ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- e) Strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “*brand name*”;
- ë) Ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë vetëm pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë për punë;

g) Ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse

➤ **Taksa mbi token bujqesore**

Toke Bujqesore eshte toka e percaktuar si e tille ne rregjistrin e zyrave te regjistrimit te pasurive. **Baza e taksës:** Eshte siperfaqja e tokes bujqesore ne hektar ne pronesi apo ne perdorim te taksapaguesit. Siperfaqja e tokes percaktohet mbi bazen e dokumentave te pronesise, formularit nr.6, aktit te pronesise, certifikates se regjistrimit te tokes.

Niveli i taksës mbi token bujqesore paraqitet si meposhte:

Taksa mbi Token Bujqesore lek/hektar/vit

Nr.	KATEGORITE E TOKES	Niveli I Tak ses		E Ardhura e Parashikuar (leke)	
1.	Kategoria e I	3640 lek/ha			
2.	Kategoria e II	2730lek/ha			
3.	Kategoria e III	1820 lek/ha			4,400,000
4.	Kategoria e IV	1755 lek/ha			4,100,000
5.	Kategoria e V	1625 lek/ha			4,900, 000
6.	Kategoria e VI	1560 lek/ha			4,445,200
7.	Kategoria e VII-X	1430 lek/ha			3,976,000
	TOTALI				21,821,200
	TOTALI	21,821,200			

Tabela.4

1. Detyrimi per taksen bujqesore llogaritet nga Drejtoria e te ardhurave dhe per te gjitha familjet per te cilat ofrohet sherbimi i furnizimit me uje nga ndermarja e ujesjellesit kjo takse vilet ne baze mujore si pjese perberese e fatures se sherbimit te furnizimit me uje nga Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Korce Sha ne cilesine e agjentit tatimor. Per sherbimin agjenti perfiton 2% te shumes se arketuar. Ndersa per fshatrat ne te cilet nuk ofrohet sherbimi apo faturimi i ujit nga ndermarje e ujesjellesit kjo takse si dhe taksat familjare do te mblidhen nga punonjesit e taksave ne njesine perkatese duke shkuar ne cdo familje.Referimi mbi te ardhurat e prithme per kete takse eshte bere bazuar ne informacionin e sjelle nga Agjensia e Bujqesise dhe e Pyjeve dhe nga ky informacion

rezulton se ne teritorin e Bashkise Devoll bazuar ne ligjin 7501 eshte ndare 12 836 ha toke bujqesore.

Struktura pergjegjese per vjeljen e takses: Per te gjitha kategorite eshte sektori i te ardhurave ne Bashkine Devoll. Ngarkohet sektori i AMT-ve prane Bashkise Devoll per percaktimin e siperfaqes ne pronesi sipas personave duke pasqyruar dhe ndryshimet e here pas hereshme dhe ia percjell kete informacion Drejtorise se te Ardhurave per llogaritjen e detyrimit. Duke pare me kujdes tabelen veme re qe nga taksa e tokes bujqesore sigurohet nje e ardhur mjaft e madhe, e cila tregon dhe orientimin bujqesor qe ka bashkia jone. Theksojme qe per vitin 2024 nuk ka asnje ndryshim ne nivelin e kesaj takse ne krahasim me vitin 2023.

➤ Taksa mbi truallin

Truall eshte nje siperfaqe toke jo bujqesore qe ndodhet brenda vijes kufizuese te ndertimit e percaktuar nepermjet dokumenteve ligjore te planifikimit e miratuar per te ndertuar mbi te.

Baza e takses: Eshte siperfaqja e truallit ne meter katror ne pronesi apo perdorim te taksapaguesit.

Niveli i takses mbi truallin paraqitet ne tabelen meposhte.

Taksa mbi Truallin lek/m²/vit

Nr.	KATEGORITE E TOKES	Niveli i Takses		E Ardhura e Parashikuar (lek)	
		Nj.Bilisht	Nj.e Tjera	Nj.Bilisht	Nj.e Tjera
1.	Taksa e truallit per banim per familjet	0.28 lek/m ²	0.28 lek/m ²	400,000	490,000
2.	Taksa e truallit per qellime biznesi	15 lek/m ²	15 lek/m ²	858,000	1,252,000
	TOTALI (Nj.A.B+Nj.A.Te tjera)	3,000,000			

Tabela.5

Detyrimi per taksen mbi truallin eshte vjetor. Drejtoria e te ardhurave kryen llogaritjen ne baze te siperfaqes dhe vleres se takses sipas tabeles dhe klasifikimit mesiper. Informacioni mbi siperfaqet e truallit per biznesin eshte siguruar nga te dhenat ne dosjet qe ndodhen per biznesin tek Drejtoria e te ardhurave. Per shumicen dermuese te subjekteve ekziston dokumentacion per siperfaqen e truallit dhe vetem per nje pjese te vogel eshte mare ne konsiderare vete deklarimi. Detyrimi per taksen e truallit per shumicen e familjeve shlyhet ne baze mujore si pjese perberese e fatures se sherbimit te furnizimit me uje nga Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Korce Sha ne cilesine e agjentit tatimor. Per sherbimin agjenti perfiton 2 % te shumes se arketuar. Ndersa per fshatrat ne njesite administrative per te cilat nuk ofrohet furnizimi me uje nga ndermarja e ujselles kanalizimeve taksat familjare do te mblidhen nga punonjesit e taksave ne njesine perkatese duke shkuar ne cdo familje.

Siperfaqet e truallit bazohet ne certifikatat e pronesise ku specifikohet metrat katrore , ndersa per familjet te cilat nuk paraqesin ose nuk zotrojne certifikaten e pronesise te siperfaqes se truallit detyrimi vjetor references i takses se truallit per familjet llogaritet per nje siperfaqe mesatare prej 300 m². Bazuar ne statistikat e mara nga gjendje civile rezulton se ne bashkine Devoll jane 13,260 familje. Detyrimi per biznesin llogaritet nga Drejtoria e te Ardhurave dhe Licensimit dhe shlyhet prane cdo banke te nivelit te dyte sipas taksave vendore te biznesit brenda dates 30.06.2024.

Niveli i takses se truallit nuk ka ndryshim per vitin 2024 krahasuar me vitin 2023.

3. Taksa e fjetjes ne hotel

Strukturat Hoteliere ne zonen tone jane te pakte ne numer dhe nuk jane te licensuara per kete aktivitet por biznese te ndryshme e ofrojne si sherbim ekstra. Zona jone nuk eshte nje zone me tipare te theksuara turistike gje e cila do te rite numrin dhe cilesine e sherbimit ne hotele. Baza e takses se fjetjes ne hotel eshte numri i neteve te qendruara ne hotel per person dhe niveli i takses se fjetjes ne hotel dhe parashikimi i te ardhurave nga kjo takes paraqitet ne tabelen meposhte:

Taksa e fjetjes ne hotel

Nr.	Emertimi i Takses	Niveli i Takses		E Ardhura e Parashikuar (lek)	
		Nj.Bilisht	Nj.e Tjera	Nj.Bilisht	Nj.e Tjera
1.	Taksa e fjetjes ne hotel	55 lek/nate	55 lek/nate	30,000	30,000
	TOTALI				
	TOTALI	60,000			

Tabela.6

Detyrimi per taksen llogaritet si shumezim i nivelit te takses se vendosur nga Bashkia, per nate qendrimi, me numrin e neteve te qendrimit ne hotel. Detyrimi per taksen i takon klientit qe streohet ne hotel e cila perfshihet ne cmimin e fjetjes dhe mbi te dhe vlere e takses dhe si rrjedhoje subjektet e hotelerise kryejne rolin e agjentit pa asnje perfitim kundrejt saj. Niveli i takses se fjetjes ne hotel nuk ka ndryshim per vitin 2024 krahasuar me vitin 2023.

Struktura pergjegjese per vjeljen e takses se fjetjes ne hotel eshte Inspektoriati Tatimor dhe Kundravajtjeve Administrative.

4. Taksa mbi kalimin e se drejtes se pronesise per pasurite e paluajtshme

Baza e takses mbi kalimin e se drejtes se pronesise per ndertesat eshte siperfaqja e ndertimit,pronesia e te ciles transferohet. Baza e takses per kalimin e se drejtes se pronesise per pasurite e tjera te paluajtshme eshte vlere e shitjes se tyre.

Taksa mbi kalimin e se drejtes se pronesise per pasurite e paluajtshme vendoset ne castin e kalimit te se drejtes se pronesise mbi to.

Taksa mbi kalimin e se drejtes se pronesise per pasurite e paluajtshme

Nr	Kategorite e ndertesave	Niveli i Takses		E Ardhura e Parashikuar (lek)	
1.	Ndertesa banimi	100 lek/m ²			300,000
2.	Ndertesa te tjera per tregeti dhe sherbime	300 lek/m ²			
3.	Ndertesa te tjera	200 lek/m ²			
	TOTALI				300,000
	TOTALI	300,000			

Tabela.7

Taksa paguhet nga personi qe kalon te drejten e pronesise mbi pasurine e paluajtshme para kryerjes se regjistrimit ne perputhje me aktet ligjore te Republikes se Shqiperise.

Menyra e mbledhjes: Agjenti tatimor per vjeljen e takses mbi kalimin e te drejtes se pronesise mbi pasurine e paluajtshme eshte Zyra Vendore e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme,e cila ne rolin e agjentit tatimor perfiton 3% te shumes se arketuar dhe diferencen e derdh per llogari te buxhetit te Bashkise Devoll jo me vone se data 30 e muajit pasardhes.

Strukturat pergjegjese per vjeljen e takses: Ngarkohet Drejtoria e te Ardhurave prane Bashkise per te bere rakordimet e te ardhurave nga kjo takse.

Duke bere nje analize te tabelës se mesiperme shohim se kemi parashikuar nje vlere mesatare per te tre kategorite e ndertesave .Referimi per planifikim eshte bere mbi rakordimet e te ardhurave qe jane realizuar per kete ze pergjate vitit 2023.

Përfashtimet:

Përfashtohen nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme:

- a) Enti Kombëtar i Banesave, Ministria e Financave dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore e qendrore;
- b) personat, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”;

c) subjektet që dhurojnë pasuri të paluajtshme kur përfitues të drejtpërdrejtë janë:

i. institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore;

ii) bashkësitë fetare ose organizatat jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi. Në këto raste dhuruesi, pasi ka marrë vërtetimin nga këshilli bashkiak për përjashtimin nga taksa, bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të dhuruar. Në çastin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesën që i takon agjentit të taksave.

Në rastet kur pranohet nga vetë palët ose kur vërtetohet ligjërisht simulim i dhurimit për llogari të një shitjeje, për shmangie nga taksa, zbatohen taksa sa dyfishi i vlerës, pavarësisht nga përgjegjësitë e tjera sipas ligjeve në fuqi.

4. Taksa e ndikimit ne infrastrukture

Kjo taksë zbatohet për zhvillimet që kërkojnë pajisjen me lejë ndërtimi dhe llogaritet mbi çmimin referencë ose preventivin e investimit të ri që kërkohet të kryhet, ose vlera ne leke e cmimit te shitjes per m² te investimit te ri. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja dhe te gjitha tarifat e tjera, paguhen para dorëzimit të dokumentit të lejës së ndërtimit. Baza e takses eshte vlera ne leke e investimit te ri qe kerkohet te kryhet. Klasifikimi si ndertim i ri percaktohet ne perputhje me legjislacionin ne fuqi per dhenien e lejes se ndertimit ne tabelen meposhte. Percaktimi i vlerave u be sipas rakordimit me Sektorin e Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit me shkrese Nr.3478 Prot,date 27/10/2023.

Taksa e ndikimit ne infrastrukture

Nr.	Kategorite e ndertimeve dhe investimeve	Niveli i Takses		E Ardhura e Parashikuar (leke)	
		Niveli i taksës në % sipas ligjit	Propozohet në %	Nj. Bilisht	Nj.e Tjera

1.	<p>Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi.</p> <p>Në këtë kategori investimesh përfshihen edhe ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi, të kushtëzuara për t'u ndërtuar si shkak i zbatimit të një kontrate koncensionare, e cila prek banesat ekzistuese.</p> <p>Gjithashtu, në këtë kategori përfshihen edhe ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit.</p>	4-8 % te cmimit te shitjes per m ²	4% te cmimit te shitjes per m ²	3,000,000
2.	<p>Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, bujqësisë; si dhe të ndërtimeve për qëllime publike. Të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara vetë nga individë apo me sipërmarrës;</p>	1-3% te vleres se investimit	3% te vleres se investimit te meret vlera me e madhe midis preventivit dhe cmimit per meter katror ndertimi sipas vkm perkatese	1,400,000
3.	<p>Per projektet e infrastructures, per ndertimin e rrugeve, tuneleve, digave, ndertimit te infrastrukturen ne energji, perfshire makinerite dhe pajisjet per keto projekte.</p>	0.1% por jo me pak se kostoja e reabilitimit te infr. se demtuar kur kjo kosto nuk eshte perfshire ne preventiv	0.1% por jo me pak se kostoja e reabilitimit te infr. se demtuar kur kjo kosto nuk eshte perfshire ne preventiv	200,000
4.	<p>Ndertimet e reja te cilat jane ne process legalizimi</p>	-0.5%te vleres se investimit per objektin e pare -Objekti I dyte legalizimi me % sipas takses se ndikimit ne infrastructure,nga ndertimet e rej sipas pikes 1 ,2 dhe 3	-0.5%te vleres se investimit per objektin e pare -Objekti I dyte legalizimi me % sipas takses se ndikimit ne infrastructure,nga ndertimet e rej sipas pikes 1, 2 dhe 3	1,000,000
5	<p>Per rikostruksionin e objekteve ekzistuese ,taksa e shqyrtimit te ketyre kerkesave te jete ne % sipas pikes 1,2 dhe 3 te vleres se preventivit</p>			200,000

6	Per ndertesat qe destinohen per qellime banimi ne zonat malore,takse e ndikimit ne infrastrukture 1% e vleres se investimit, Keshilli Bashkiak percakton me vendim Zona Malore per efekt te zbatimit te kesaj takse	200,000
	TOTALI (Nj.A.B+Nj.A.Te tjera)	6,000,000

Tabela.8

Baza e takses shprehet si perqindje e vleres se investimit. Detyrimi per taksen i takon investitorit.

Perjashtime nga Taksa e Ndikimit ne Infrastukture:

- Autoriteti vendor i planifikimit nuk e paguan taksen nga ndertimet e reja per zhvillimet e veta me fonde publike.
- Investimet e kryera per ndertimin e strukturave akomoduese Hotel/Resort me 5 Yje ,status special , sipas percaktimeve ne legjislacionin e fushes se turizmit dhe qe jane mbartes te nje marke tregetare te njohur nderkombetarisht.
- Investimet e subjekteve te cilat zhvillojne veprimtarine pritese te certefikuuar si agroturizem ,sipas legjislacionit ne fuqi ne fushen e turizimit .
- Investimet per rindertimin , riparimin apo restaurimin e ndertesave te destinuara per qellime banimi, te demtuara si pasoje e fatkeqesive natyrore , sipas perkufizimit te ligjit ne fuqi per mbrojtjen Civile. Kushtet, rregullat dhe dokumentet qe shoqërojnë kërkesën për përjashtimin nga detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas kësaj pike, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Struktura pergjegjese per vjeljen e takses: Struktura e ngarkuar dhe pergjegjese per llogaritjen dhe pagesen e takses se ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja eshte Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit,e cila percjell informacion ne Dreitoria te Ardhurave.Te gjitha subjektet ndertuese do te terheqin lejen e ndertimit prane Bashkise Devoll vetem pasi te kene paguar taksen e ndikimit ne infrastrukture. Referimi per shumen e pritshme per realizim eshte bere mbi te ardhurat e realizuara per kete ze pergjate vitit 2023.

6. Taksa e regjistrimit te pervitshem te mjeteve te perdorura

